

Nr. 317 Prot.

Dt. 15.02.2021



2. kopoj
Per informacion

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

11/02/2021

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT
DEKANATI

Nr. 75 Prot.

Tiranë më, 11 / 02 / 2021

Lënda: Kriteret për aplikimin dhe përzgjedhjen e studenteve në Ciklin e Pare dhe të Dytë për vitin akademik 2022-2023 në Fakultetin e Bioteknologjise dhe Ushqimit

REKTORATIT TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

A. Kriteret e pranimit Ciklin e Pare të Studimit, Bachelor

a. Pranimi në programet e studimit të Ciklit të Parë të Studimeve, Bachelor është i mundur për çdo kandidat i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm si dhe që plotëson:

- **Kriterin e meritës.** Nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
- **Kriterin e rëndësisë** (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjise dhe Ushqimit).
- **Notën e lëndëve me zgjedhje**
- **Kuotat e paracaktuara** nga Fakulteti i Bioteknologjise dhe Ushqimit

b. Përzgjedhja e kandidateve fitues në Ciklin e Pare të Studimeve bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë

$$A * K * 0.9 + B * 0.1$$

Ku: A = Nota mesatare e shkolles se mesme
K = koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjise dhe Ushqimit
B = nota e lendes me zgjedhje

duke gjeneruar kështu një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditur sipas kësaj liste brenda kuotave të paracaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit për çdo program studimi.

B. Kriteret e pranimit në ciklin e dytë të studimeve "Master i Shkencave"

a. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën "Master i Shkencave" studentët të cilët kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare "Bachelor" ose "Master Profesional" në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë:

- *Kriterin e meritës:* Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë "Bachelor", të jetë 6.5 e lart. Në rast se ka ende kuota të lira, nuk do përjashtohen aplikantët me mesatare më të ulët, por në asnjë rast më të ulët se 6.
- *Kriterin e rëndësisë:* (koeficienti i profilin të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit.
- *Kuotat e përcaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit.*

b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në ciklin e dytë të studimeve "Master i Shkencave" do të bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë:

$$A * K$$

Ku: A = Nota mesatare e ciklit të parë të studimeve "Bachelor"

K = Koeficienti sipas profilin dhe programit të studimit që aplikohet

Mbi bazën e kriterëve të mësipërme gjenerohet kështu një listë vlerësimi e cila shpall fituesit të renditur brenda kuotave të paracaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit për çdo program studimi.

Koeficientet e profilin të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit për çdo program studimi janë si më poshtë:

- Kandidatët e diplomuar në Teknologji Agroushqimore, Vreshtari-Enologji, Shkencat e Ushqimit, Bioteknologji Ushqimore, Kimi Ushqimore do të kenë koeficientin 1.00
- Kandidatët e diplomuar jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi koeficientin 0.90.

C. Kriteret pranimit në "Master Profesional"

a. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën "Master Profesional" studentët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare "Bachelor", në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë:

- *Kriterin e meritës:* Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor".

- *Kriterin e rëndësisë:* Koeficientin e profilit të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit.
- *Kuotat e paracaktuara* nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit.

b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në ciklin e dytë të studimeve “Master” Profesional do të bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë:

$$A * K$$

Ku: A = Nota mesatare e e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”
K= Koeficienti sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet.

- Kandidatët e diplomuar në Teknologji Agroushqimore, Vreshtari-Enologji, Shkencat e Ushqimit, Bioteknologji Ushqimore, Kimi Ushqimore do të kenë koeficientin 1.00.
- Kandidatët e diplomuar jashtë profileve të studimit që do t# aplikojn# do t# kenë koeficientin 0.85.

Bashkëngjitur kësaj shkrese gjeni tabelën e koeficientëve të profileve të shkollave të mesme të propozuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit.

Me konsideratë,

Prof. Dr. Kapllan Sulaj



KOEFICIENTËT E PROFILEVE TË SHKOLLAVE TË MESME PËR FBU

Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit				
Index Profili:	Profili i shkollave të mesme / Programet e studimit	Programet e studimit "Bachelor"		
		Teknologji Agroushqimore	Vreshtari Enologji/Enologji dhe Teknologji e Pijeve	Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit
0	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	0.8	0.8	0.8
1	GJIMNAZ	1	1	1
2	GJIMNAZ ME KOHË TË SHKURTUAR	0.95	0.95	0.95
3	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-FRENGJISHT	0.9	0.9	0.9
4	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-ITALISHT	0.9	0.9	0.9
5	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT	0.9	0.9	0.9
6	GJIMNAZ GJUHËSOR	1	1	1
7	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	0.8	0.8	0.8
8	SHKOLLË SPORTIVE	0.8	0.8	0.9
9	SHKOLLË PEDAGOGJIKE	0.9	0.9	0.9
10	HOTELERI-TURIZËM	1.2	1.2	1.2
11	SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI	0.9	0.9	0.9
12	MEKANIKË	1	1	0.9
13	ELEKTROTEKNIKË	0.9	0.9	0.9
14	ELEKTRONIKË	0.9	0.9	0.9
15	PËRPUNIM DRURI	0.8	0.8	0.8
16	NDËRTIM	0.7	0.7	0.7
17	TEKSTIL-KONFEKSIONE	0.7	0.7	0.7
18	TEKNOLOGJI USHQIMORE	1.3	1.3	1.3
19	BUJQËSI	1.2	1.2	1.2
20	SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE	0.9	0.9	1
21	VETERINARI	0.8	0.8	1
22	GJEODEZI	0.7	0.7	0.7
23	INSTALUES I SISTEMEVE TERMOHIDRAULIKE	0.9	0.9	0.8
24	LLOGARI	0.8	0.8	0.8
25	SHËRBIME BANKARE	0.7	0.7	0.7
26	ADMINISTRIM BIZNESI	0.8	0.7	0.8
27	RRJETE TË DHËNASH	0.7	0.7	0.9
28	MBËSHTETJE E PËRDORUESVE TË TIK	0.8	0.8	0.8
29	TEKNOLOGJI KIMIKE	1.2	1.2	1.2
30	SIPËRMARRJE E AGJENCISË TURISTIKE	0.9	0.9	0.9
31	AGROBIZNES	0.8	0.8	0.8
32	ZHVILLIM WEBSITE	0.7	0.7	0.7
33	SIGURIME	0.7	0.7	0.7

34	SILVIKULTURË	0.9	0.9	0.9
35	HARRY FULTZ, BIZNES	0.8	0.8	0.8
36	HARRY FULTZ, ELEKTRONIKË	0.8	0.8	0.8
37	HARRY FULTZ, AUTOMEKANIK	0.8	0.8	0.8
38	PETER MAHRINGER, TEKNOLOGJI INFORMACIONI	0.8	0.8	0.8
39	PESHKIM	0.8	0.8	0.9
40	GJEOLLOJJI-MINIERA	0.7	0.7	0.7
41	TREGTI	0.8	0.8	0.8
42	RRJETE TË DHËNASH (PILOT-GIZ)	0.8	0.8	0.8
43	INXHINIERI INFORMATIKE SOFTWARESH(HERMANN GMEINER)	0.7	0.7	0.7
44	TEKSTIL-KONFEKSIONE(NABER ADA)	0.7	0.7	0.7
45	DETARI	0.7	0.7	0.7
46	PROFILI IM NUK ËSHTË NË LISTË	0.7	0.7	0.7
47	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP GJERMANISHT FAIK KONICA	0.8	0.8	0.8
49	SHKOLLË SPORTIVE	0.7	0.7	0.8
50	KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM NAFTE, GAZI DHE UJI	0.8	0.8	0.8
51	SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR (PILOT – GIZ)	0.7	0.7	1
97	PETER MAHRINGER, TEKNOLOGJI INFORMACIONI	0.8	0.8	0.8
98	ELEKTRONIKË NË TEKNOLOGJINË E AUTOMATIZIMIT	0.9	0.8	0.8
99	VJEN NGA JASHTË SHTETIT	1	1	1
100	GJIMNAZ - f1	1	1	1
101	GJIMNAZ - f2	1	1	1
102	GJIMNAZ - KINGS TIRANA	1	1	1
103	GJIMNAZ - 2 KURRIKULA	1	1	1
104	GJIMNAZ - f1 - 2 kurrikula	1	1	1
105	GJIMNAZ - mix	1	1	1
106	GJIMNAZ - MIST	1	1	1
201	GJIMNAZ - 2 KURRIKULA KSH	1	1	1
601	GJIMNAZ GJUHËSOR - P.S	0.9	0.9	0.9

DEKANI
Prof. Dr. Kapllan Sulaj

